

SKELETKURRIKULI

Për kualifikimin profesional

SILVIKULTURË

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit IV ne KEK²
(2 vjeçar)

Kodi: S1-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

- 1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2.Korniza Europiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë” niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**
- XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Silvikulturë” Niveli IV në KSHK.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, të kualifikimit “Pyje”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me pyjet*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtijshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë” niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin profesional “Pyje”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente;

- të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- të konceptojë planin për sipërmarrje dhe edukim karriere në pyje, kullota dhe prodhime të dyta pyjore;
- të kryejë planifikimin, organizimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave dhe punimeve silvikulturale;
- të mbikëqyrë procesin e grumbullimit të farave të prodhimit të materialit mbjellës për pyllëzime;
- të zbatojë projektet e pyllëzimit dhe të marrë masat për mbrojtjen e objekteve të pyllëzuara;
- të kryejë të gjitha punimet e nevojshme si anëtar në grupin e punës për: inventarizimin dhe mbarështimin e pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore e eterovajore;
- të kryejë matje gjeodezike bazë në planifikimin e territorit dhe hapësirave të gjelbra;
- të zbatojë projektet për mbarështimin e faunës dhe organizimin e gjuetisë;
- të kryejë sipas metodikave dhe formularëve model, monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së fondit pyjor/kullosor, bimëve mjekësore, eterovajore dhe të faunës;
- të marrë të gjitha masat e përcaktuara për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- të kryejë punime në lultari dhe të zbatojë projekte gjelbërimi në sipërfaqe të vogla;
- të ndjekë zbatimin e projekteve tekniko-ekonomike të shfrytëzimit të ngastrës pyjore/ grup ngastrave pyjore të caktuara për shfrytëzim, si dhe transportin e materialit drusor që rezultojnë nga shfrytëzimi;
- të zbatojë bazën ligjore dhe nënligjore për: administrimin e fondit pyjor/kullosor, zonat e mbrojtura, gjuetinë, bimët mjekësore eterovajore, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e tokës, legjislacionin tatimor dhe kodin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e teknikut të silvikulturës. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit të punësohet në drejtoritë e shërbimit pyjor, por edhe të vetpunësohet duke hapur biznesin

e tij në fushën e fidanishteve pyjore, kultivimit të luleve, prodhimeve të dyta të pyllit dhe nxjerrjes së produkteve, mbrojtjes së mjedisit pyjor etj. Pas një përvoje pune e trajnimeve të vazhdueshme, ai mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në veprimtarinë e silvikulturës.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare si dhe të arsimit pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	10/11 (360/ 396)	14/15 (448/ 480)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	2
7		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1	1
8		Gjeografi	1	-
9		Biologji	-	2
10		Fizikë	-	1
11		Shkenca sociale	-	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (288)	10 (320)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2	2
2	L-03-229-25	Gjeodezi dhe planifikim territori	1	1
3	L-25-230-17	Silvoteknika	2	-
4	L-25-231-25	Teknologjia e shfrytëzimit pyjor	1	-
5	L-25-232-25	Mbarështim pyjesh dhe kullotash	2	2
6	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	1
7	L-25-438-17	Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës	-	2
8	L-25-235-25	Florikulturë	-	1
9	L-25-236-25	Ligjshmëria pyjore	-	1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	9 (324)	6 (192)
1	M-25-646-20	Punime me instrumenta matës gjeodezije	36	-
2	M-25-647-20	Kubimi i grumbullit pyjor dhe drurit në këmbë	36	-
3	M-25-648-20	Ndërtimi i veprave hidroteknike në sistemime malore	72	-
4	M-25-649-20	Punime në inventarizimin e pyjeve-1	36	-

5	M-25-1333-20	Damkimi dhe llogaritja e vëllimit të lëndës drusore	36	-
6	M-25-659-20	Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme.	36	-
7	M-25-1334-25	Pyllëzimet me farë.	36	-
8	M-25-653-20	Inventarizimi dhe zënia e fidanave	36	-
9	M-25-654-20	Punimet në inventarizimin e pyjeve-2	-	33
10	M-25-1335-20	Trajtimet në pyjet fletorë, halorë dhe të përzier	-	60
11	M-25-656-20	Hartimi i planit të biznesit në aktivitete pyjore	-	33
12	M-25-657-20	Punime dhe shërbime në lultari	-	33
13	M-25-660-20	Shërbime dhe punime në kullota	-	33
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (108)	-
1	M-25-651-20	Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në fidanishtet pyjore	36	-
2	M-25-658-20	Inventarizimi dhe vjelja e gjahut	36	-
3	M-25-1336-20	Trajtimi i shëlgjishteve për prodhim thupre	36	-
4	M-25-2172-25	Shfrytëzimi i pyjeve me makina të automatizuara	36	
5	M-17-2199-25	Shoqëria e nxënësve	36	
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/1116)	30/31 (960/992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

1. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e

hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm në kualifikimin profesional “Silvikulturë”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

1. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI)
- b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të njohurive nga lëndët teorike, të përgjithshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të sektorit të silvikulturës. Në përfundim, nxënësve u jepet diploma e maturës shtetërore si dhe certifikata e përgatitjes profesionale, në të cilat evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike të përgjithshme dhe profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, si dhe rezultatet e provimeve përfundimtare.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Silvikulturë”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e maturës shtetërore profesionale si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional në nivelin e teknikut/menaxherit në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
- rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve;
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse;
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme;
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to;
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup;
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore;
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj;
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme;
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes;
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre;
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve;
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajnë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 72 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë

Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë
Tema 20	Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme	4 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve;
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit;
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi;
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit;
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi;
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi;
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi;
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi;
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi;
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes;
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve;
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet;
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë

Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Gjeodezi dhe planifikim territori” (L-03-229-25), kl.12-36 orë dhe kl.13-32 orë

• Synimet e lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori”, kl 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori”, klasa12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë bazat teorike, metodat, pajisjet dhe instrumentet e thjeshtë të matjes së distancave, këndeve, disniveleve dhe pjerrësive në hapësirë;
- të shpjegojnë elementet e hartës topografike dhe imazhet satelitore;
- të përcaktojnë largësitë dhe kuotat e pikave në terren dhe në hartë;
- të masin kënde horizontale dhe vertikale gjatë punimeve të ndryshme;
- të masin sipërfaqe të parcelave me metodën grafike në hartë;
- të përdorin instrumentat e nivelimit.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori”, kl.12 – 36 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi gjeodezinë.	4 orë
Tema 2	Pajisje dhe instrumenta të matjes të elementeve topografike	3 orë
Tema 3	Plani, hartat topografike dhe imazhet satelitore	8 orë
Tema 4	Matja e këndeve	4 orë
Tema 5	Matja e largësive	4 orë
Tema 6	Matja e sipërfaqeve	3 orë
Tema 7	Përcaktimi i pozicionit në plan të pikave të sipërfaqes së tokës .	4 orë
Tema 8	Përcaktimi i pozicionit në lartësi të pikave të sipërfaqes së tokës.	5 orë
Tema 9	Rilevime takeometrike	1 orë

• Synimet e lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori” kl. 13 - 32 orë

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori”, klasa13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe implementimit të territorit në lidhje me mbrojtjen e natyrës;
- të shpjegojnë rëndësinë e zhvillimit të integruar dhe metodat kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të peizazhit natyror;
- të shpjegojnë planifikimin e zhvillimit të pyjeve urbane dhe parqeve në zonat e banuara;
- të përshkruajnë institucionet që merren me planifikim e territorit.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gjeodezi dhe planifikim territori”, kl.13 - 32 orë

Tema 1	Objekti, rëndësia e mbrojtjes së mjedisit e planifikimit të territorit.	4 orë
Tema 2	Mbrojtja e natyrës e përdorimi i tokës.	6 orë
Tema 3	Mbrojtja e ruajtja e jetës së egër ne pyll	8 orë

Tema 4	Peisazhet natyrore, rëndësia metodat kryesore të planifikimit	3 orë
Tema 5	Qëllimi i planifikimit të territorit	2 orë
Tema 6	Detyrat e planifikimit të territorit	3 orë
Tema 7	Organizimi i hapësirave të gjelbërta në zonat natyrore	4 ore
Tema 8	Institucionet që merren me planifikimin e territorit	2 orë

3.

Lënda “Silvoteknika” (L-25-230-17) , kl, 12 -72 orë

- Synimet e lëndës “Silvoteknika” kl. 12 - 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Silvoteknika” kl 12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kontributin e silvoteknikës në intensifikimin e procesit të prodhimit pyjor
- të përcaktojnë premiset ekonomike dhe biologjike të prerjeve kulturore ;
- të klasifikojnë prerjet kulturore;
- të shpjegojnë teknikat e zbatimit të prerjeve kulturore;
- të përcaktojnë metodat e zbatimit të prerjeve kulturore;
- të përcaktojnë efektet e zbatimit të prerjeve kulturore;
- të dallojnë format e mbarështimit të pyjeve;
- të përcaktojnë trajtimet në format e ndryshme të mbarështimit të pyjeve;
- të përcaktojnë mënyrat e shndërrimit të pyjeve;
- të zbatojnë trajtime në pyje;
- të përcaktojnë llojin e prerjeve kulturore në varësi të fazës së zhvillimit të pyjeve;
- të përcaktojnë drurët që do të hiqen gjatë prerjeve kulturore;
- të vlerësojnë materialin drusor të dalë nga prerjet kulturore;
- të llogarisin intensitetin e prerjeve kulturore.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Silvoteknika” , kl 12- 72 orë**

Tema 1	Kujdesi për grumbujt pyjor dhe drejtimi i tyre	11 orë
Tema 2	Organizimi dhe planifikimi i prerjeve kulturore	14 orë
Tema 3	Trajtimi i pyjeve trungjishte	10 orë
Tema 4	Trajtimi i pyjeve cungjishte	4 orë
Tema 5	Trajtimi i pyjeve cungjishte të përbëra	11 orë
Tema 6	Trajtimi i pyjeve halorë në vendin tonë	6 orë
Tema 7	Trajtimi i pyjeve fletorë në vendin tonë	16 orë

4. Lënda “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor” (L-25-231-25), kl 12 – 36 orë

- Synimet e lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor”, kl . 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor”, kl.12 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimin e shfrytëzimit pyjor;
- Të organizojnë mënyrën e shfrytëzimit të ngastrave pyjore;
- Të zbatojnë procesin teknologjik të prodhimit të lëndës në pyll në fazat e tij;
- Të listojnë asortimentet të cilat nxirren nga shfrytëzimi i pyjeve;
- Të shpjegojnë mjetet dhe mekanizmat e shfrytëzimit pyjor;
- Të tregojnë standardet e asortimenteve të cilat nxirren nga shfrytëzimi i pyjeve dhe të realizojnë asortimin e drurit të rrëzuar;
- Të shpjegojnë format e transportit të brendshëm dhe zgjedhjen e tyre në ngastra pyjore;

- Të zgjedhin vendet e depozitimit dhe mjetet e ngarkimit të materialit;
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë gjatë organizimit të punës për prerjen, transportin dhe ngarkimin e materialit drusor;
- Të rendisin mënyrat e shfrytëzimit të prodhimeve të dyta drusore dhe jo drusore;
- Të shpjegojnë mënyrat e nxjerrjes së esencave nga disa lloje drusore dhe barishtorë;
- Të plotësojnë dokumentacionin shoqërues të lëvizjes së materialit drusor kur i kërkohet.

• **Përmbajtja e përgjithshme e lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor”, kl 12-36 orë**

Tema 1	Objekti dhe qëllimi i shfrytëzimit pyjor	1 orë
Tema 2	Procesi i prodhimit të asortimenteve drusore	6 orë
Tema 3	Mjetet dhe mekanizmat që përdoren në procesin e shfrytëzimit pyjor	4 orë
Tema 4	Transporti i brendshëm i materialit drusor	5 orë
Tema 5	Depozitimi dhe ngarkimi i materialit drusor	2 orë
Tema 6	Shfrytëzimi racional i pyjeve dhe ruajtja e materialit drusor	2 orë
Tema 7	Organizimi i shfrytëzimit pyjor dhe dokumentacioni teknik	16 orë

5. Lënda “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, (L-25-232-25), kl. 12 -72 orë dhe kl. 13 - 64 orë

• **Synimet e lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash” kl. 12- 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 12, nxënësit duhet:

- Të përcaktojnë parimet bazë të mbarështimit të pyjeve.
- Të klasifikojnë pyjet sipas funksioneve të tyre.
- Të ndajnë ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parcela.
- Të dallojnë vetitë strukturore që ndryshojnë në parcelë.
- Të përcaktojnë format e shfrytëzueshmërisë.
- Të listojnë metodat që përdoren në përcaktimin e shfrytëzueshmërisë.
- Të përcaktojnë ndryshimet ndërmjet fondit të prodhimit real dhe normal.
- Të llogaritin ciklin e prodhimit.
- Të ndajnë ciklin në periudha.
- Të përcaktojnë metodat e mbarështimit në forma të ndryshme regjimesh.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 12-72 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mbarështimin e pyjeve	11 orë
Tema 2	Elementët tekniko – ekonomik të mbarështimit të pyjeve	5 orë
Tema 3	Format e metodat e përcaktimit të shfrytëzueshmërisë	13 orë
Tema 4	Njohuri të përgjithshme për fondin e prodhimit	13 orë
Tema 5	Njohuri të përgjithshme për ciklin e prodhimit	6 orë
Tema 6	Rregjimi dhe trajtimi	4 orë
Tema 7	Mbarështimi i trungjishteve të rregullta	11 orë
Tema 8	Mbarështimi i trungjishteve kopshtorë	6 orë
Tema 9	Mbarështimi i cungjishteve	3 orë

• **Synimet e lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 13- 64 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 13 nxënësit duhet:

- të përcaktojnë llojet e hartave në punimet e mbarështimit në pyje dhe kullota;
- të dallojnë shenjat kufitare që përdoren në terren dhe në hartë;
- të plotësojnë formularët e përshkrimit të ngastrave në mbarështim pyjesh dhe kullotash;
- të shpjegojnë përmbajtjen dhe përdorimin e udhëzuesit për hartimin e planeve të mbarështimit dhe inventarizimin të pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës dhe bimëve mjeksore, eterovajore;
- të nxjerrin të dhëna nga plani i mbarështimit për zbatimin e tij;
- të dallojnë livadhet, kullotat dhe pyjet që kulloten;
- të listojnë emrat e bimëve të dëmshme dhe helmuese;
- të përcaktojnë llojet e bimëve njëvjecare dhe shumëvjecare;
- të klasifikojnë kullotat sipas kohës së përdorimit;
- të klasifikojnë kullotat sipas bimësisë barishtore;
- të përcaktojnë rrugët e rritjes së efektivitetit të kullotave dhe infrastrukturën e nevojshme;
- të organizojnë sistemet e ndryshme të kullotjes;
- të përcaktojnë kohën dhe rregullat e shtegimit të kafshëve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 13-64 orë**

Tema 1	Studimi dhe përshkrimi i kushteve natyrore të prodhimit	10 orë
Tema 2	Metodat e matjes së grumbujve pyjorë	7 orë
Tema 3	Teknika e mbarështimit të pyjeve	9 orë
Tema 4	Udhëzuesi për hartimin e planeve të mbarështimit dhe inventarizimi i pyjeve ,kullotave zonave të mbrojtura, faunës dhe bimëve mjekësore, eterovajore	4 orë
Tema 5	Zbatimi i planeve të mbarështimit	3 orë
Tema 6	Njohuri të përgjithshme për kullotat dhe livadhet	3 orë
Tema 7	Bimësia e kullotave	8 orë
Tema 8	Klasifikimi i kullotave	2 orë
Tema 9	Përmirësimi i kullotave	12 orë
Tema 10	Shfrytëzimi i kullotave	6 orë

6. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, (L-05-198-24), kl. 13 -32 orë

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër;
- të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale;
- të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij;
- të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin;
- të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre;
- të shpjegojnë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme;
- të përshkruajnë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore;
- të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimit dhe zgjidhjet digjitale;
- të shpjegojnë kuptimin e cikleve të jetës së produktit dhe krijimin e mbetjeve;
- të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese;

- të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklimit;
- të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimet profesionale mbi reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin;
- të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve;
- të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklimit duke përdorur teknologjinë;
- të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve;
- të shpjegojnë rëndësinë e ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital të burimeve ujore në drejtimet profesionale përkatëse;
- të përshkruajnë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse;
- të dallojnë dhe përdorin sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit dhe cilësisë së ujit;
- të shpjegojnë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit;
- të përshkruajnë transportin e qëndrueshëm, lëvizshmërinë e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimet profesionale përkatëse;
- të dallojnë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje) si dhe përdorimin e mjeteve elektrike në veprimtari të ndryshme profesionale;
- të dallojnë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm si dhe Integrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik;
- të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital;
- të dallojnë praktikën etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimet e tyre mjedisore;
- të shpjegojnë praktikën dhe platformën e qëndrueshme të tregtisë elektronike si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore;
- të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktikën e ekonomisë së gjelbër dhe digjitale;
- të shpjegojnë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale;
- të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13-32 orë**

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimi i mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

7. Lënda “Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës” (L-25-438-17) , kl. 13-64 orë

• **Synimet e lëndës “ Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës ”, kl. 13**

Në përfundim të lëndës “Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës”, kl.13 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e lëndës “Pyllëzime artificiale”;
- Të përshkruajnë llojet e vendit dhe të huaja;
- Të përshkruajnë pyjet e thjeshta e të përziera;

- Të shpjegojnë zgjedhjen e llojeve në bazë të tipit të pyllit ekzistues, studimit të ambientit dhe eksperimentit;
- Të vendosin llojet e drurëve që mund të përdoren në vendin tonë;
- Të shpjegojnë përzierjet e llojeve të drurëve pyjorë;
- Të ndërtojnë skemat e pyllëzimeve artificiale ;
- Të shpjegojnë mënyrat e pyllëzimeve ;
- Të përshkruajnë mënyrat e mbjelljes së fidanëve;
- Të argumentojnë mirëmbajtjen e kulturave ;
- Të shpjegojnë pyllëzimet në ranishtet bregdetare;
- Të përshkruajnë pyllëzimet në tokat e rrëshqitshme;
- Të ndërtojnë brezat mbrojtës;
- Të përshkruajnë mbjelljet anës rrugëve;
- Të shpjegojnë mbjelljet në zonat e gjelbra;
- Të shpjegojnë kultivimin e halorëve;
- Të argumentojnë shërbimet në kulturat fletore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës”, kl 13 - 64 orë**

Tema 1	Njohuritë e përgjithshme për pyllëzimet, zgjedhja e llojeve	8 orë
Tema 2	Teknikat e pyllëzimit	10 orë
Tema 3	Pyllëzimi me farë, fidane dhe kalema	8 orë
Tema 4	Mirëmbajtja e tokës dhe kulturave	2 orë
Tema 5	Pyllëzime në toka të zhveshura,të pyllëzuara.	5 orë
Tema 6	Zbatime pyllëzime ne raste te vecanta	7 orë
Tema 7	Brezat mbrojtës	5 orë
Tema 8	Mbjellja gjatë rrugëve	2 orë
Tema 9	Zonat e gjelbra urbane dhe mikrobazenet.	2 orë
Tema 10	Kultivimi i halorëve kryesorë ne zonat e thata të ultësirës	6 ore
Tema 11	Kultivimi i drurëve fletorë dhe shkurreve për mbrojtjen e tokës.	9 orë

8. Lënda “Florikulturë” (L-25-235-25), kl. 13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Florikulturë”, kl. 13**

Në përfundim të lëndës “Florikulturë”, kl. 13 nxënësit duhen :

- Të shpjegojnë vlerat e bimëve të zbukurimit.
- Të përshkruajnë kushtet për rritjen e zhvillimin e luleve në mjedise të hapura e banimi;
- Të rendisin shërbimet e luleve;
- Të përshkruajnë sektorët e prodhimeve të luleve;
- Të shpjegojnë mënyrat e shumimit të luleve;
- Të rendisin lulet 1 vjeçare dhe shumëvjeçare ;
- Të shpjegojnë trajtimin e luleve në mjedise të brendshme dhe të jashtme;
- Të shpjegojnë mënyrat e shumimit të bimëve shumëvjeçare;
- Të shpjegojnë ruajtjen e qeporeve ;
- Të shpjegojnë mjediset e mbrojtura;
- Të rendisin bimët mishtore;
- Të hartojnë një projekt gjelbërimi për sipërfaqe të vogla

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Florikulturë”, kl. 13 – 32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi bimët e zbukurimit	2 orë
Tema 2	Shumimi i bimëve	2 orë
Tema 3	Shërbimet kulturale	2 orë
Tema 4	Sektorët e prodhimit	2 orë
Tema 5	Bimët 1 vjeçare	4 orë
Tema 6	Bimët 2 vjeçare	4 orë
Tema 7	Bimët shumëvjeçare	4 orë
Tema 8	Bimët qepore	4 orë
Tema 9	Kultura të bimëve të mjediseve të mbrojtura	3 orë
Tema10	Bimët mishtore	2 orë
Tema11	Hartimi i një projekti gjelbërimi	3 ore

9. Lënda “Ligjshmëria pyjore” (L-25-236-25), kl. 13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Ligjshmëria pyjore”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ligjshmëria pyjore”, klasa13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë funksionet e menaxhimit të shërbimit pyjor.
- Të klasifikojnë pronësinë e fondit pyjor dhe kollusor kombëtar dhe kadastrën kombëtare.
- Të rendisin funksionet e policisë pyjore.
- Të përshkruajnë fondin pyjor privat dhe pyjet në mbrojtje të vecantë.
- Të konceptojnë dispozitat ligjore mbi Shërbimin pyjor, trajtimin e kullotave dhe livadheve.
- Të përshkruajnë legjislacionin mbi ruajtjen e natyrës zonave të mbrojtura gjuetinë BBMT/ te dhe të biodiversitetit.
- Të konceptojnë legjislacionin mbi peshkimin , akuakulturën dhe ushtrimin e gjuetisë.
- Të përshkruajnë bazën ligjore në fuqi për Lejet, Licensat, Autorizimet për ushtrimin e veprimtarive dhe aktiviteteve në fondin pyjor dhe kullosor.
- Të përshkruajnë legjislacionin tatimor dhe kodin e punës.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ligjshmëria pyjore”, kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Bazat ligjore për administrimin e fondit pyjor kullosor	7 orë
Tema 2	Baza ligjore për bimët mjeksore dhe eterovajore	4 orë
Tema 3	Kuadri ligjor, mbrojtja e natyrës, mbrojtja e tokës dhe zonat e mbrojtura.	5 orë
Tema 4	Baza ligjore për faunën dhe gjuetinë	5 orë
Tema 5	Baza ligjore për lejet, autorizimet për aktivitetet të ndryshme në fondin kullosor	4 orë
Tema 6	Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluejtshme (SRPP)	3 orë
Tema 7	Legjislacioni i punës dhe kodi i etikës në punë	4 orë

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punime me instrumenta matës gjeodezie”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT				
Titulli dhe kodi	PUNIME ME INSTRUMENTA MATËS GJEODEZIE			M-25-646-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në përdorimin e instrumentave matës të gjeodezisë.			
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore			
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.			
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat vlerësimit	RN 1	Nxënësi përcakton pikat e poligonit në terren. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vëzhgojë zonën që do rilevohet – të përcaktojë vendin e pikave të poligonit – të përpilojë skicat e zonës – të përcaktojë grupin e punës që do rilevojë – të zgjidhë mjetet matëse dhe të punës – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.		
	RN 2	Nxënësi mat brinjët dhe këndet e poligonit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të matë brinjët e poligonit në vajtje; – të matë brinjët e poligonit në ardhje; – të drejtojë zhalonin gjatë matjes së brinjëve; – të plotësojë tabelën e matjeve në lartësi; – të masë këndet e brëndshme të poligonit me teodolit; – të përcaktojë metodat e matjes së këndeve ; – të matë këndet në dy pozicione dylbije; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli		

RN 3 Nxënësi kryen punime nivelimi të pikave të poligonit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë instrumentin nivelues;
- të përgatisë niveluesin për punë;
- të nivelojë pika të poligonit duke përdorur metodën gjeodezike nga mesi;
- të plotësojë librezën e nivelimit;
- të trasferojë kuotën e pikës vajtje – ardhe;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nivelimit të pikave të poligonit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen punime dhe matje në çdo pikë qëndrimi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të caktojë grupin e nivelimit;
- të përcaktojë anëtarët e grupit;
- të vendosë teodolitin në pozicion pune;
- të vendosë latat në pikat e qëndrimit;
- të masë lartësitë për çdo pikë qëndrimi;
- të orientohe me instrumentin matës;
- të matë pikat me detaje;
- të kryejë lexime në lartësi;
- të kontrollojë punimet për çdo pikë qëndrimi;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen hedhje të pikave në planshetë në zyrë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë llojin e letrës së vizatimit;
- të vendosë në leter pikat e qëndrimit me koordinatë ose raportor;
- të vendosë pikat me detaje në letrën e vizatimit;
- të realizojë interpolimin e izoipseve;
- të kontrollojë pikat e interpoluara;
- të vizatojë me tush objektet, izoipse dhe rrjedhjet ujore.
- të plotësojë kornizën e planshetës;
- të përcaktojë sipërfaqen e zonës me planimetër polar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore. – Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të matjeve të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore me Teodolit dhe nivelues, të demostrojë plotësimin e tabelave të nivelimit dhe të matjeve me teodolit, të demostrojë mbajtjen dhe leximin e lates në pikat e poligonit, të hedhë në planshet të dhënat e grumbulluara dhe të realizojë në zyrë mbylljen e poligonit. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, përcaktimin e sipërfaqeve pyjore për matje me teodolit dhe nivelues, përpilimin e tabelave dhe librit të nivelimit, matjen e pikave të poligonit dhe leximin me instrumenta matës. – Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e planshetës, hedhjen e pikave të poligonit në planshete si dhe matjen e sipërfaqes me planimetër polar. – Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve.. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e matjeve gjeodezike ne terren dhe në zyrë.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor – Mjete matëse gjeodezike, teodolit e nivelues, lata, planimetër polar, metër shirit – Komplete veshje të punëtorit në fushën e pyjeve.. – Hipsometër, – Diametër matës, latë, zhalon , piketa druri – Tabela të gatshme për hedhjen e të dhënave te grumbulluara nga matjet. – Harta dhe busull orientuese. – Makinë llogaritëse, kanceleri te ndryshme si fletë vizatimi, letër kalk etj

2. Moduli “Kubimi i grumbullit pyjor dhe drurit në këmbë”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUBIMI I GRUMBULLIT PYJOR DHE DRURIT NE KEMBE	M-25-647-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kubimin e drurit në këmbë dhe grumbullit pyjor.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat vlerësimit	RN 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për kubimin e grumbullit pyjor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të analizojë grumbullin pyjor; – të përcaktojë sipërfaqen e grumbullit pyjor dhe fuqinë lëndore në pyll; – të ndajë sipërfaqen në pjesë homogjene; – të realizojë inventarizimin e pjesshëm e të përgjithshëm; – të zgjedhë metodat e kubimit. – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vendit të punës. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi kubon drurin në këmbë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë sipërfaqet pyjore për kubimin e drurit; – të zgjedhë drurët që do kubohen; – të matë diametrin e drurit në lartësinë 1,30m; – të matë lartësinë me hipsometër; – të llogaritë vëllimin e drurit; – të nxjerrë koeficientin e formës; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit në këmbë. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 3 Nxënësi kubon grumbullin pyjor me sipërfaqe provë e	

prerje rrah.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqet e kubimit të grumbullit pyjor ;
- të përcaktojë përqindjen e inventarizimit;
- të zgjedhë sipërfaqen provë;
- të përcaktojë madhësinë e sipërfaqes provë;
- të zgjedhë formën e sipërfaqes provë;
- të piketojë sipërfaqen provë;
- të kuboje sipërfaqen provë dhe grumbullin pyjor;
- të hedhë të dhënat në tabelat e kubimit dhe të llogarisë vëllimin e grumbullit pyjor.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të grumbullit pyjor me sipërfaqe provë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kubon drurin me inventarizim , pa drurë mesatarë.

Kriteret e vlerësimit :

Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- të përcaktojë sipërfaqen e kubimit të grumbullit;
- të masë diametrat e drurit ;
- të masë lartësitë e drurëve;
- të hartojë listë- damkën e sipërfaqes së kubimit;
- të hartojë kurbën e lartësise së kompesuar;
- të llogarisë vëllimin për njësi;
- të llogarisë vëllimin e përgjithshëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit me inventarizim.

Instrumenti i vëzhgimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kubon grumbullin pyjor me inventarizim me drurë model.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqet pyjore për kubimin e grumbullit;
- të inventarizojë diametrat e grumbullit pyjor;
- të përcaktojë drurët model;
- të zgjedhë në terren drurin model;
- të përcaktojë numrin e drurit model;
- të llogaritë kubimin e drurit model;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të grumbullit pyjor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësit kubon grumbullin pyjor me metoda të thjeshta dhe të shpejta (Metoda Biterlik).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë sipërfaqen pyjore të kubimit;
- të përcaktojë sipërfaqen bazimetrike të grumbullit;
- të përcaktojë numrin e sipërfaqeve rrethore;
- të masë lartësinë e drurit;
- të llogarisë lartësinë mesatare;
- të përcaktojë koeficientin e formës;
- të hartojë pasqyrat e përgjithshme të kubimit të drurit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojë mjedisin gjatë kubimit të grumbullit pyjor me metoda të thjeshta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore . – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të kubimit të drurit dhe te grumbullit pyjor, të masë diametrat dhe lartësitë e drurit , të plotësojë tabelat e kubimit të drurit dhe të grumbullit pyjor, të bëjë llogaritjen e inventarizimit të sipërfaqeve pyjore. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore , përcaktimin e sipërfaqeve pyjore për kubimin e grumbullit, zgjedhjen e drurëve që do kubohen , përpilimin e tabelave të kubimit dhe përgatitja e list damkave, matjen e diametrit dhe të lartësisë së drurit si dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme në këtë modul. – Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave të përcaktimit të vëllimit të kubimit të drurit në këmbë dhe listë damkave. – Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve.. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e kubimit te drurit dhe vlerësimit të masës drusore.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme: – Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor. – Mjete pune të ndryshme – Komplete veshjesh për punëtorin e fushës së pyjeve. – Hipsometër, diametër matës. – Tabela të gatshme si listë damke dhe tabela të kubaturës për të hedhur të dhënat e grumbulluara. – Harta dhe busull orientuese. – Makinë llogaritëse , kanceleri të ndryshme etj

3. Moduli “Ndërtimi i veprave hidroteknike në sistemime malore”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I VEPRAVE HIDROTEKNIKE NË SISTEMIME MALORE	M-25-648-20
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune për ndërtimin e veprave hidroteknike	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit(RN)dhe procedurat vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndërton drena të ndryshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë vendin për ndërtimin e drenave. – të përgatisë mjetet e punës. – të përcaktojë materialet që do përdoren. – të grumbullojë materialet. – të përgatitë vendin e punës. – të ndërtojë drena. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësit ndërton gradona dhe mure mbajtëse Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë vendin ku do ndërtohen muret mbajtëse – të përcaktojë vendin ku do ndërtohen gradonat – të përcaktojë llojet e gradonave – të përzgjedhë materialet që do përdoren – të ndërtojë muret mbajtëse (mur i thatë) – të ndërtojë gradona. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.	

e prej shtresash me thupra,

ndërtohen veprat tërthore;
e që do ndërtohen;
ve;

ndërtimin e veprave tërthore

pragjet prej druri;

e fashina ose thupra.

RN 4 Nxënësi cakton vendin për ndërtimin e pritave dhe kryen piketimin e pritës .

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin ku do ndërtohet prita;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për piketimin e pritës;
- të përzgjedhë materialet për ndërtimin e pritave;
- të përcaktojë kushtet gjeoteknike, topografike , konstruktive dhe ekonomike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi bën punime biologjike për forcimin e brigjeve të kanaleve dhe përrenjve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë punimet biologjike për përforcimin e brigjeve të kanaleve dhe përrenjve;
- të përzgjedhë farat e barit;
- të përzgjedhë vendin ku do nxirren plisat e dheut me bar;
- të përzgjedhë veglat e punës ;
- të përzgjedhë farat e barit;
- të vendosë plisa në brigje;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale – Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrimet konkrete. – Nxënësit duhet të angazhohen me veprimtari konkrete pune. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset e punës, materialet e ndryshme dhe veglat si më poshtë: – Kazma, lopata, tezga, motosegë, gërrshërë, sopatë. – Manuale udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtuam në modul.

4. Moduli “Punime në inventarizimin e pyjeve-1”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NË INVENTARIZIMIN E PYJEVE-1	M-25-649-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet në inventarizimin e pyjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndan ekonominë pyjore në ngastra dhe nën/ngastra. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të grumbullojë bazën materiale që nevojitet për inventarizimin e pyjeve; – të kufizojë në hartë ekonominë pyjore; – të ndajë në hartë ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parcela; – të ndajë në terren ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parcela; – të verifikojë përputhjen e ndarjes në hartë me ndarjen në terren; – të vendosë shenjat kufitare në terren; – të numërojë dhe të shënojë parcelat dhe nën /parcelat në hartë; – të numërojë dhe të shënojnë parcelat dhe nën/parcelat në terren; – të respektojë rregullat për ndarjen e ekonomisë pyjore në parcela dhe nën/parcela; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes së ekonomisë pyjore në parcela; Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi përshkruan stacionin pyjor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të plotësojë të dhënat identifikuese të ekonomisë; – të përshkruajë gjendjen aktuale të ekonomisë pyjore; – të përcaktojë kategorinë e përdorimit të territorit; – të përcaktojë funksionin e pyllit duke u bazuar në kriteret	

grumbullin pyjor.

ë:

n e qeverisjes së grumbullit pyjor
së ripërtëritjes;
zhvillimit të grumbullit pyjor mbi
ve dendrometrike;
n e grumbullit pyjor;
n e vegjetacionit të grumbullit pyjor;
në ekzistuese në pyll;
en e dëndësisë, lartësisë dhe moshën

shkurreve në pyje;

n e shpërndarjes së shkurreve;

ndësinë e grumbullit pyjor;

n e grumbullit pyjor;

e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së
imit të grumbullit pyjor.

;

trulli.

përkatëse;

- të përshkruajë konfiguracionin e terrenit;
- të përcaktojë kundrejtimin e ekonomisë;
- të përcaktojë lartësinë mbi nivelin e detit;
- të përcaktojë tipin e tokës;
- të përcaktojë teksturën e tokës.
- të përcaktojë Ph-shin e tokës;
- të përcaktojë tipin e erozionit;
- të plotësojë skedat e përshkrimit parcelarë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përshkrimit të stacionit pyjor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në zonë pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer inventarizime në pyjet fletorë dhe halorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e pyjeve fletorë dhe halorë fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve, si dhe të llogaritjeve të intensiteteve të prerjeve.

ë

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer trajtime në pyje.
 - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
 - Katalogë dhe manuale.
-

5. Moduli “Damkimi dhe llogaritja e vëllimit të lëndës drusore”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DAMKIMI DHE LLOGARITJA E VËLLIMIT TË LËNDËS DRUSORE	M-25-1333-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit me mënyrat e damkimit dhe të vlerësimit të masës drusore në pyll.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënësit(RN) dhe procedurat vlerësimit	RN 1	Nxënësi përgatit ngastrat për damkim. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të ngrejë grupin e punës dhe ndajë detyrat; – të përdorë planet e mbarështrimit; – të përcaktojë parcelat e nën/parcelat për damkim; – të përcaktojë drurët që do damkosen; – të zgjedhë mjetet e punës për damkim; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë lëvizjes në parcela. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi damkos drurin. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jenë të aftë: – të përcaktojë mënyrat e lëvizjes së grupit në parcelë; – të shënojnë drurët me çekiç damkë; – të masë me diametër matës diametrin e drurit; – të grumbullojë të dhënat për llogaritjen e vëllimit të masës drusore; – të vendosë shenjat e damkimit në fund të drurit; – të vendosë shenjat e damkimit në lartësinë 1,5- 2 m; – të gdhendë lëvoren deri në blanë; – të vendosë numrin rendor të damkimit me bojë; – të hartojë list -damkat për çdo ditë dhe çdo parcelë; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë damkosjes së drurit. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore . – Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të damkimit të vlerësimit të masës drusore, të ndarjes së materialit drusor në asortimente sipas diametrit, të kolaudojë parcelat ku është shfrytëzuar materiali. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, ndarjen e brezave dhe percaktimin e drurëve që damkosen, verifikimin e materialit drusor, mënyrën e vendosjes së damkës, të përdorë çekiçin e damkimit dhe mjetet e tjera të punës. – të kolaudojë parcelat, të llogarisë vëllime, të lexojë listëdamka, të përdorë çekiçin e damkimit dhe mjetet e tjera të punës. – Përpilimin e listëdamkave të terrenit. – Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave të percaktimit të vëllimit dhe listë damkave. – Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e damkimit të drurit dhe vlerësimit të masës drusore, percaktimit dhe ndarjes së drurit në lëndë punimi dhe dru zjarr , si dhe asortimentet përkatëse.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor. – Mjete pune te ndryshme – Komplete veshjesh për punëtorin në fushën e shfrytëzimit të pyjeve. – Çekiç damkë,diametrë matës, hipsometër, metër shirit. – Tabela te gatshme si listë damke dhe tabela të kubaturës për të hedhur të dhënat e grumbulluara. – Harta dhe busull orientuese. – Makinë llogaritëse,bojë zmalto etj.

6. Moduli “Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I PYLLIT PËR QËLLIME TË POSAÇME	M-25-659-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të trajtuar pyllin për qëllime të posaçme.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi trajton pyllin për mbrojtjen e tokës nga gërryerja. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë formën e qeverisjes së pyllit me funksion mbrojtjen e tokës nga gërryerja; – të zbatojë trajtimin kopshtor në trungjishte; – të zbatojë variantin me breza të këmbyer në cungjisht; – të përcaktojë gjatësinë e brezit; – të përcaktojë drejtimin e brezit; – të vlerësojë materialin drusor të prerë; – të pastrojë pyllin nga mbeturinat; – të rregullojë përzierjen e llojeve me mbjellje të llojeve fletorë; – të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit; Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi trajton zonat e gjelbërta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të heqë drurët e padëshiruar në zonat e gjelbërta; – të krasitë degët e kurorave; – të mbjellë lloje dekorative në këto zona; – të mbjellë shkurre dekorative; – të krasitë kurorat e shkurreve duke i dhënë forma të ndryshme; – të mbjellë lule që formojnë mozaik ngjyrash; – të mirëmbajë territoret që shërbejnë për dëfrime; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe

mbrojtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësit trajtojnë pyjet parqe (pyje ekzistuese natyrore).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë prerjet kopshtore për të mbajtur të përhershëm vegetacionin në pyje;
- të zbatojë prerjet sanitare në pyjet parqe;
- të pastrojë pyllin nga ferrat dhe mbeturinat;
- të mbjellë lloje të ndryshme pyjore për të rregulluar përbërjen e pyllit;
- të mirëmbajë livadhet me pastrime;
- të mbjellë bar në sipërfaqe boshe(livadhe).
- të mbjellë shkurre si mjet strehimi dhe ushqimi për faunën e pyllit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve në parqe.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në pyjet me funksione të posaçme. – Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer trajtimet në pyje për qëllime të posaçme. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në pyjet për qëllime të posaçme fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve për qëllime të posaçme dhe të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme: – Ekonomi pyjore për të kryer trajtimin e pyjeve. – Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore. – Katalogë dhe manuale,plane mbarështimi.

7. Moduli “Pyllëzimet me farë”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PYLLEZIMET ME FARE	M-25-1334-2
Qëllimi i modulit	Nje modul që aftëson nxënësit për të kryer pyllëzimet artificiale me farë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi grumbullon, trajton dhe përgatit farën për mbjellje Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të grumbullojë farën sipas llojit të drurit të përcaktuar në projekt; – të seleksionojë farën sipas cilësisë; – të mbikëqyrë ruajtjen dhe tharjen e farërave; – të trajtojë para mbjelljes farën nëse është e nevojshme; – të mbikëqyrë procesin e përcaktimit të fuqisë mbirëse të farave; – të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi punon tokën. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të punojë tokën sipas mënyrës së përcaktuar në projekt; – të përcaktojë plehrat që do të përdoren; – të përcaktojë rrugët e lëvizjes në objekt. Instrumentete vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 3 Nxënësi kryen mbjelljen me shpërndarje. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të përcaktojë rradhën e punës; – të përzgjedhë farën dhe të realizojë përzierjen në rastet me pyllëzime me më shumë se një lloj druri;	

- të caktojë zgjedhjen e veglave;
- të bëjë shpërndarjen e farës sipas normës;
- të mbulojë farën;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen mbjelljen me rreshta.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zbatojë skemat e mbjelljes;
- të përzgjedhë veglat e punës;
- të bëjë piketimin e vijave;
- të hapë vijat;
- të hedhë farën;
- të mbulojë farën;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen mbjelljen me gropa.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skicat;
- të përcaktojë rradhën e punës;
- të piketojë vendin;
- të përzgjedhë veglat;
- të bëjë hapjen e gropave;
- të kryejë vendosjen e farërave;
- të mbulojë farën;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise për praktikant profesionalë në parcelën pranë shkollës, në sipërfaqet e zhveshura ku do kryhen pyllëzime artificiale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrime konkrete në proceset e punës në pyjet artificiale.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për mbjelljen e farërave, në fillim të mbikëqyrës dhe me pas të punojë në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në pyllëzimet artificiale. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të verifikohet shkalla e arritjes së shprehive praktike për realizimin e mënyrave të mbjelljes.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritje e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për
cdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen
mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Parcelë për kryerjen e praktikës
 - Hartë topografike
 - Vegla të thjeshta dore, si kazma, bel, shatë, krëhëra etj
 - Fara të ndryshme
 - Skema mbjelljesh dhe punimi të tokës
 - Uniforma e punës
 - Katalog, manuale të ndryshme.
-

8. Moduli “Inventarizimi dhe zënia e fidanave”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI DHE ZËNIA E FIDANAVE	M-25-653-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të inventarizuar zënet e fidanave në pyjet artificiale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi inventarizon kulturat uniforme si dendësi dhe rritje. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të orientohet me hartën topografike të pyllit; – të bëjë ndarjen në blloqe të përafërta; – të nxjerrë sipërfaqet provë në hartë; – të kufizojë sipërfaqen provë në terren; – të numërojë fidanët e mbira; – të numërojë fidanët e dështuar; – të përllogarisë numrin e fidanëve në sipërfaqen provë; – të përllogarisë përqindjen e fidanëve të zëna në sipërfaqen provë; – të nxjerrë rezultatet për të gjithë sipërfaqen; – të vlerësojë masat që duhen marrë për të ardhmen; – të nxjerrë detyrat që dalin nga inventarizimi; – të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë inventarizimit të kulturave uniforme. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi bën inventarizimin me kulturë jo uniforme në dendësi e rritje. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të nxjerrë hartën topografike; – të bëjë orientimin me hartë; – të ndajë në blloqe sipërfaqen e mbjellë; – të bëjë përkufizimet në hartë; – të ndajë parcelën në sipërfaqen një hektarëshe; – të numërojë numrin e rreshtave të mbjellë;

- të numërojë numrin e bimëve në një rresht;
- të nxjerrë numrin e bimëve jo uniforme;
- të numërojë bimët me rritje optimale;
- të përlogarisë zënien në një hektar;
- të nxjerrë rezultatet për gjithë sipërfaqen;
- të nxjerrë masat që duhen marrë për të siguruar numrin optimal të bimëve;
- të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë inventarizimit me kulturë jouniforme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimit të nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në parcelën pranë shkollës, në pyjet artificiale. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demostrime konkrete të proceseve të punës në pyllzime artificiale. Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për shërbimet në pylltari, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me proceset e ndryshme të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësve bëhet verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në pyllzimet artificiale. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kritereve të realizimit të specifikuara për cdo rezultat të të mesuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Parcelë për kryerjen e praktikës – Harta topografike, fletore shënimesh, formularë model për inventarizimin e zenjeve ne pyllëzime, lapsa, vizore, etj. – Uniformat e punës – Katalogje etj.

9. Moduli “Punimet në inventarizimin e pyjeve - 2”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIMET NË INVENTARIZIMIN E PYJEVE-2	M-25-654-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet në inventarizimin e pyjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 12 të kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli i IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zbaton metodat e matjes në trungjishtet e rregullta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë metodën e matjes në trungjishtet e rregullta; – të llogaritë numrin e sipërfaqeve provë që do të merren në ekonominë pyjore; – të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë; – të përcaktojë vendin ku do të merren sipërfaqet provë; – të inventarizojë drurët brenda sipërfaqeve provë; – të masë diametrin e drurëve në lartësi 1.30 cm nga toka; – të masë lartësinë e drurëve; – të përcaktojë moshën e drurëve; – të hedhë të dhënat e matjeve në fletën e inventarizimit; – të llogarisë dm, Hm dhe Mm të drurëve të sipërfaqes provë; – të plotësojë tabelat e fuqisë lëndore; – të llogarisë fuqinë lëndore të sipërfaqes provë; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të matjeve në trungjishte. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi zbaton metodat e matjes në trungjishtet kopshtore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë metodën e matjes në trungjishtet kopshtore; – të llogaritë numrin e sipërfaqeve provë që do të merren në ekonominë pyjore; – të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë;

- të përcaktojë vendin ku do të merren sipërfaqet provë;
- të inventarizojë drurët me diametër 6cm e lart brenda sipërfaqeve provë;
- të zbatojë udhëzimin, që drurëve 6-10 cm të mos u llogaritet fuqia lëndore;
- të matë lartësinë e drurëve;
- të matë diametrin e drurëve në lartësi 1.30 cm nga toka;
- të përcaktojë moshën e drurëve;
- të hedhë të dhënat e matjeve në fletën e inventarizimit;
- të llogarisë dm, Hm dhe Mm të drurëve të sipërfaqes provë;
- të llogaritë vëllimin e drurëve për cdo kategori diametrike;
- të llogaritë vëllimin për Ha të trungjishteve kopshtore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë matjeve në trungjishte kopshtore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësit zbatojnë metodat e matjes në cungjishte.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë numrin e sipërfaqeve provë;
- të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë;
- të përcaktojë vendin ku do merren sipërfaqet provë;
- të presë brenda sipërfaqes provë të gjithë drurët me prejardhje farore;
- të presë drurët në gjatësi standarde 1m;
- të stivosë drurët në stiva;
- të masë vëllimin në ms;
- të kthejë vëllimin në m³ duke e shumëzuar me koeficientin e stivimit;
- të plotësojë tabelën e fuqisë lëndore të cungjishteve për dru zjarri;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë matjeve në cungjishte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në zonë pyjore
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer inventarizime në pyjet fletorë dhe halorë
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në inventarizimin e pyjeve fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi

	i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në inventarizimin e pyjeve, te përdorimi i mjeteve të punës për realizimin e këtyre proceseve, si dhe te plotësimi i formularëve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme: – Ekonomi pyjore për të kryer inventarizimin e pyjeve. – Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore. – Katalogë dhe manuale, plane inventarizimi.

10. Moduli “Trajtimet në pyjet fletorë, halorë dhe të përzierë”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMET NË PYJET FLETORË, HALORË DHE TË PËRZIER	M-25-1335-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të trajtuar teknikisht pyjet fletorë dhe halorë.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasen e 12 të kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli i IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit(RN)dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi trajton pyjet e ahut. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përgatisë mjetet e punës që nevojiten gjatë zbatimit të trajtimeve në pyje; – të llogaritë intensitetin e ndërhyrjes duke marrë sipërfaqe provë; – të krijojë biogrupet dhe të përcaktojë drurët e së ardhmes; – të shënojë drurët që do të hiqen me prerjet rralluese; – të zbatojë metodën e rrallimit nga lart në drurët e klasave të para dhe të dyta të rritjes; – të vlerësojë materialin drusor të dalë nga prerja sipas dimensioneve që ato kanë; – të nxjerrë materialin drusor jashtë parcelës dhe të pastrojë sipërfaqen e prerjes; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të ahut. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Nxënësit trajtojnë pyjet e gështenjës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përgatitë mjetët e punës që i nevojiten gjatë zbatimit të trajtimit; – të llogarisë intensitetin e prerjeve që do të zbatohet në pyjet e gështenjës; – të zbatojë rrallimet në pyjet e gështenjës; – të kryejë shkalbëzime në gështenja; – të lyejë me bojë- vaji vend prerjen; – të përcaktojë llojin e krasitjes në pyjet e gështenjës;	

e fletorë të përzier.

ë:

ore të përzierjes së grumbullit;

a dhe të treta të përzierjes;

rajtimin që do të zbatohet;

atitore para hapjes së çeltirave;

ë ndihmuar ripërtëritjen;

ë për të ndihmuar ripërtëritjen;

ojë trajtimin);

undimtare;

a drusor të dalë nga prerja;

e ripërtëritje artificiale;

ripërtëritjen e pyllit;

e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së

t të fletorëve të përzier.

;

trolli.

- të zbatojë krasitjen në kurorë;
- të cungojë majat e degëve në kurorat e gështenjave;
- të pastrojë mjetet e punës;
- të pastrojë parcelat pas zbatimit të trajtimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të gështenjës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi trajton plepishtet.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të caktojë qëllimin ekonomik dhe ciklin e prodhimit në plepishte;
- të përcaktojë skemën e pyllëzimit në plepishte;
- të mbjellë fidanë plepi me lartësi mbi 5m;
- të kryejë shërbime në plepishte;
- të kryejë përmirësime në plepishte;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të plepishteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësit trajton pyjet e lajthisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet e punës që nevojiten gjatë trajtimit të pyjeve të lajthisë;
- të kryejë krasitjen formuse të kurorës;
- të heqë thithka dege të thara ose të thyera;
- të kryejë krasitje të prodhimit;
- të ricungojë kurorën;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të lajthisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi trajton pyjet e pishës së zezë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë formën e qeverisjes së pyllit;
- të përcaktojë llojin e trajtimit që do të zbatohet;
- të shënojë drurët që do hiqen gjatë prerjeve farore;
- të llogarisë intensitetin e këtyre prerjeve;
- të zbatojë prerjet farore;
- të punojë sipërfaqen e tokës dhe të pastrojë barnat për të ndihmuar ripërtëritjen natyrore;
- të zbatojë prerjet përfundimtare;
- të pastrojë parcelën;
- të kryejë shërbime në filizërine e re;
- të zbatojë prerjet kulturore (pastime e rrallime);
- të vlerësojë materialin drusor të prerë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të trajtimit të pishës zezë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi trajton pyjet e bredhit.***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë trajtimin që do të zbatohet;
- të përzgjedhë veglat e punës;
- të llogarisë intensitetin e prerjeve farore;
- të zbatojë prerjet farore;
- të zbatojë prerjet përfundimtare;
- të plotësojë sipërfaqet boshe me ripërtëritje artificiale;
- të kryejë shërbime në filizërinë e bredhit;
- të zbatojë rrallimet nga poshtë;
- të zbatojë rrallimet nga lart;
- të vlerësojë materialin drusor në asortimente;
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të trajtimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Udhëzime
për
zbatimin e
modulit
dhe
vlerësimin
e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në një zonë pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për të kryer trajtime në pyjet fletorë dhe halorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e pyjeve fletorë dhe halorë fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi

i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e këtyre proceseve, si dhe të llogaritjeve të intensiteteve të prerjeve.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:

- Ekonomi pyjore për të kryer trajtime në pyje.
- Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
- Katalogë dhe manuale.

11. Moduli “Hartimi i planit të biznesit në aktivitete pyjore”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HARTIMI I PLANIT TË BIZNESIT NË AKTIVITETE PYJORE	M-25-656-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer llogaritje ekonomike për aktivitetet pyjore	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 12 të kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli i IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e fidanëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e fidanëve; – të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e fidanëve; – të përcaktojë koston e punës(pagat, sig. shoqërore,etj); – të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh,etj); – të llogarisë detyrimet fiskale në prodhimin e fidanëve; – të llogarisë të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të fidanëve; – të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për prodhimin e fidanëve; – të përgatitë faturën për koston e fidanëve; – të komunikojë me profesionalizëm e me etikë profesionale; – të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit dhe reklamën. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e thuprës së shëlgut. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e thuprës së shëlgut; – të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e thuprës së shëlgut;	

- të përcaktojë koston e punës(pagat, sig. shoqërore,etj);
- të përcaktojë kosto të tjera(transport, energji, amortizim pajisjesh,etj);
- të llogarisë detyrimet fiskale në prodhimin e thuprës së shëlgut;
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin gjatë prodhimit të thuprës së shëlgut;
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e thuprës së shëlgut;
- të përgatisë faturën për koston e thuprës;
- të komunikojë me profesionalizëm e me etikë profesionale;
- të kryjë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit dhe reklamën.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore .

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore;
- të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e bimëve eterovajore;
- të përcaktojë koston e punës(pagat, sig. shoqërore, etj);
- të përcaktojë kosto të tjera(transport, energji ,amortizim pajisjesh, etj);
- të llogaritë detyrimet fiskale në prodhimin e bimëve eterovajore;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të bimëve eterovajore;
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e bimëve eterovajore;
- të përgatitë faturën për koston e bimëve eterovajore;
- të komunikojë me profesionalizëm e me etikë profesionale;
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit dhe reklamën.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë, pranë drejtorive të shërbimit pyjor në rreth, si dhe në biznese private në fushën e pyjeve .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të llogaritjeve ekonomike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve praktike për llogaritje të thjeshta

	ekonomike të hartimit të një plan biznesi të një aktiviteti pyjor si në aktivitete të prodhimit të rrëshirës, prodhimit të fidanëve pyjore, të prodhimit të shëlgjeve dhe për prodhimin e produkteve drusore dhe jo drusore në pyje. – Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm, analizën e këtyre dokumentacioneve dhe nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishëm financiar. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të ndryshme për realizimn e llogaritjeve të thjeshta ekonomike, përcaktimin e cmimit të kostos dhe fitimit të çdo produkti të përmendur më sipër.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Modele projektsh te aplikuar ne fushën e pyjeve. – Pajisje kancelarie. – Interneti – Makina llogaritëse dore. – Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos. – Përmbledhje e legjislacionit në fushën e pyjeve që lidhet me prodhimet pyjore(kodi i punës, legjislacioni fiskal). – Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

12. Moduli: “Punime dhe shërbime në lultari”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME DHE SHERBIME NE LULTARI	M-25-657-20
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer shërbime në lultari.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 12 të kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli i IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen shumëzimin e bimëve me farë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të mbledhë dhe përpunojë farërat; – të ruajë farërat; – të përpunojë farërat; – të dezinfektojë farën; – të shtratifikojë farën; – të bëjë mbjelljen e farërave. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi kryen shumëzimin vegjetativ. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të ndajë copat për mbjellje; – të ndajë copat rrënjore; – të ndajë copat gjethore; – të bëjë shartimin; – të bëjë përpajen ajrore; – të caktojë shumëzimin me ndarje; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 3	Nxënësi kryen shërbime. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të punojë tokën; – të bëjë mbjelljen e farës;

- të bëjë ndërrimin e fidanëve
- të ujisë fidanët;
- të spërkasë fidanët;
- të prashisë fidanët;
- të krasitë bimët;
- të mbrojë nga ngricat;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi ndërton shtratin e nxehtë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jete i aftë:

- të analizojë skicat;
- të zgjedhë vendin;
- të përzgjedhë materialet;
- të përgatisë materialin për ngrohje;
- të mbushë shtratin e nxehtë;
- të mbjellë farërat;
- të kryejë shërbime në shtratin e nxehtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikë profesionale në parcelën pranë shkollës, në fidanishtet. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demostrime konkrete të proceseve të punës në lultari. Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për shërbimet në lultari, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me proceset e ndryshme të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësve bëhet verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në fidanishte. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Parcelë për kryerjen e praktikës – Vegla të thjeshta dore, si kazma, bel, shatë, cfurqe, krëhëra, etj – Tezga – Pleh organik, dherishte – Preparate për dezinfektim – Farëra të ndryshme të luleve – Uniformat e punës – Katalogje etj.

13. Moduli “Shërbime dhe punime në kullota”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME DHE PUNIME NË KULLOTA	M-25-660-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer shërbime dhe punime në kullota.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 12 të kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli i IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen përmirësimin sipërfaqësor të kullotave. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të pastrojë gurët në sipërfaqe; – të pastrojë gurët gjysëm të futur në tokë; – të transportojë gurët; – të klasifikojë gurët; – të krijojë brezare me mure të thata; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përmirësimit sipërfaqësor të kullotave. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi pastron kullotat nga shkurret. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të identifikojë shkurret; – të pastrojë me shkulje; – të pastrojë me djegie; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë pastrimit të kullotave. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 3	Nxënësi mirëmban kullotat. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të plehrojë kullotat me plehra azotikë; – të plehrojë kullotat me plehra fosforikë; – të plehrojë kullotat me plehra organikë;

- të kryejë kullimin e ujit të tepërt;
- të sigurojë numrin e bimëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në kullotë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në kullota e livadhe. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për shërbimet e punimet në kullota. – Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për të punuar dhe shërbyer në kullota e livadhe, në fillim në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Ata duhet të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për të marrë prodhime të mira në kullota e livadhe. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve në shërbime dhe punime në kullota. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës për të kryer procese pune në kullota e livadhe. – Komplet i velgave, veshjet, paisjet dhe materialet e nevojshme për të kryer shërbime të ndryshme. – Plehra kimikë, organikë, kosa, drapër, makina korrëse, vende për manipulimin e barit. – Katalogje, manuale udhëzues etj.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në fidanishtet pyjore”

Kualifikim profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LUFTIMI I SËMUNDJEVE DHE DËMTUESVE NË FIDANISHTET PYJORE	M-25-651-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të përcaktuar dhe luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit e fidanave pyjorë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi grumbullon gjethe e fidanë të dëmtuar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vëzhgojë fidanët; – të grumbullojë gjethe e sëmura; – të mbledhë fidanët e dëmtuar; – të vlerësojë karakterin e dëmit; – të grumbullojë larvat; – të grumbullojë insektet; – të identifikojë sëmundjet; – të përcaktojë dëmtuesit; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë grumbullimit të gjetheve e fidanëve të dëmtuar. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi merr masa parandaluese për të luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të mbledhë farëra të pastra; – të mbledhë fidanë të shëndoshë; – të pastrojë tokën nga barërat e këqija; – të bëjë punimin e tokës; – të bëjë frezimin e tokës; – të bëjë diskimin e tokës; – të vendosë breza ngjitës;

- të vendosë drurë kurth;
- të bëjë shkatërrimin e qeskave të vemjeve;
- të presë pjesët e infektuara;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë marrjes së masave parandaluese ndaj sëmundjeve të fidanëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi lufton sëmundjet këpurdhore e bakteriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përcaktojë fungicidin;
- të përcaktojë përqëndrimin në bazë të fidanit;
- të përcaktojë përzierjen;
- të verifikojë reaksionin me letër lakmues;
- të përgatisë veglat për spërkatje;
- të kryejë spërkatjen e fidanëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e sëmundjeve në fidanishte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi lufton insektet që dëmtojnë fidanët

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë ushqimet e helmuara;
- të shpërndajë ushqimet e helmuara;
- të përgatisë preparatet në forme lëngu;
- të përcaktojë tretësirën;
- të përlllogarisë sasinë e preparatit që duhet kg/ha;
- të përgatisë mjetet që duhen për spërkatje;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e dëmtuesve në fidanishte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në fidanishtet pyjore. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për të mbrojtur fidanët në fidanishte. – Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për të mbrojtur fidanët në fidanishte, në fillim në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Ata duhet të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për të mbrojtur fidanët nga sëmundjet dhe dëmtuesit. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i
--	---

	shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve për të mbrojtur fidanët. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedisë të praktikës për të mbrojtur fidanët në fidanishte. – Komplet i veglave, veshjet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për të kryer spërkatje të ndryshme, pompa shpine, shkallë, këmbaleca elektricisti, rrip sigurimi, gërrshërë, qeska të ndryshme, etj). – Preparate dhe solucione kimike për mbrojtjen e fidanëve. – Katalogje, manuale udhëzues etj.

2. Moduli “Inventarizimi dhe vjelja e gjahut”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI DHE VJELJA E GJAHUT	M-25-658-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në njohjen e karakteristikave të gjahut në vendin tonë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të nxënit(RN)dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen vrojtime në sipërfaqet pyjore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vëzhgojë terrenin; – të zgjedhë hartën orientuese; – të përcaktojë rradhën e punës në rezervat; – të ndajë grupet e punës sipas detyrave ; – të përcaktojë vendndodhjen e kafshëve dhe shpendëve; – të përgatisë mjetet e punës; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vrojtimeve në sipërfaqet pyjore. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi inventarizon shpendët dhe kafshët në zonat pyjore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë zonën e inventarizimit; – të zgjedhë hartën orientuese të zonës pyjore; – të zgjedhë sipërfaqet provë; – të specifikojë llojet nëpërmjet personave (teknikë dhe gjuetarë); – të verifikojë dokumentacionin për llojet; – të përpilojë tabelat e inventarizimit për sipërfaqe provë; – të llogarisë për gjithë zonën të gjithë sasinë e gjahut; – të përgatisë hartën me simbole për kafshët dhe shpendët e zonës; – të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë inventarizimit të shpendëve. Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi organizon gjuetinë për kafshët dhe shpendët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pëcaktojë zonën e gjuetisë së kafshëve dhe të shpendëve;
- të zgjedhë mënyrat më të mira për gjuajtjen e kafshëve dhe shpendëve;
- të vendosë tabelat lajmëruese për zonën se ku do gjuhet për të lajmëruar popullsinë;
- të përgatisë kurthet e kapjes së gjahut duke zgjedhur llojet e tyre;
- të vendosë kurthet në vëndet e përcaktuara gjatë rikunjucionit të terrenit;
- të përgatisë armën për gjuajtje , duke e zgjedhur tipin dhe cilësinë e saj (çifte);
- të përgatisë municionin duke zgjedhur fishekët në varësi të tipit të armës.
- të evidentojë kafshët dhe shpendët e gjuajtura nëpërmjet numërimit të tyre.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjuajtjes me çifte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore ose në rezervate gjuetie. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të inventarizimit dhe të vjeljes së gjahut si dhe hartimin e tabelave dhe të hartës së gjuetisë me simbolet përkatëse. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, ndarjen e zonave të inventarizimit ,zgjedhjen e sipërfaqeve provë, specifikimin e llojeve ,verifikimin e gjahut, grumbullimin e të dhënave në drejtoritë e shërbimit pyjor por edhe nga popullsia e zonës dhe nga gjuetarët të përdorë armën e gjahut. – Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave të inventarizimit dhe përcaktimin e llojeve dominuese të zonës dhe të ndërtojnë hartën me përfaqësuesit kryesorë të kafshëve dhe shpendëve të zonës. – Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve.. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e inventarizimit të gjahut , të formave dhe mënyrave të gjuajtjes si dhe te përcaktojë llojet e kafshëve dhe shpendëve në përgatitjen e hartës me llojet përkatëse të zonës.
--	---

Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, paisjet dhe materialet e mëposhtme: – Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor. – Mjete pune të ndryshme – Komplete veshjesh për gjuhëtarin – Pankarta për njoftime të ndryshme – Arma e gjahut dhe fishekë të llojeve të ndryshme . – Kurthe ose leqe si dhe materiale për përgatitjen e tyre – Kancelari për përgatitjen e hartës dhe mbajtjen e shënimeve – Tabela të gatshme për të hedhur të dhënat e grumbulluara . – Dokumente të D.SH. Pyjor mbi të dhënat e zonës. – Harta dhe busull orientuese në terren.
---	---

3. Moduli “Trajtimi i shëlgjishteve për prodhim thupre”

Kualifikimi profesional : Silvikultuë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I SHËLGJISHTEVE PËR PRODHIM THUPRE	M-25-1336-20
------------------	---	--------------

Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune shëlgjishte për prodhim thupre.
-------------------	---

Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore
-----------------------	-----------------

Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të drejtimit mësimor “Pyje”.
---------------------------------	--

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përgatit kalemat e shëlgut për mbjellje. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë thuprën për përgatitje kalemash; – të përzgjedhë mjetet e punës për prerje; – të trajtojë thuprën para prerjes së kalemave; – të presë kalemat sipas standardit; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë prerjes së kalemave. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e kalemave të shëlgut. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë punimin qelizëm të tokës; – të përcaktojë skemën e mbjelljes; – të përcaktojë mënyrën e mbjelljes; – të mbjellë kalemën e shëlgut; – të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrollit.
	RN 3	Nxënësi kryen shërbime në shëlgjishte. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të thajë barin; – të prashitë tokën; – të kryejë plehërimin e tokës;

- të kryejë zëvendësimin e kalemave të tharë me kalema të rinj;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrollit.

RN 4 Nxënësi shfrytëzon shëlgun e kultivuar.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vjelë thuprat e shëlgut;
- të lidhë thuprat në tufa;
- të bëjë sistemimin dhe tharjen e thuprave të shëlgut;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrollit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	– Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në shëlgjishte – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete pune shëlgjishte për prodhim thupre. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune shëlgjishte për prodhim thupre fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës shëlgjishte për prodhim thupre. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës shëlgjishte për prodhim thupre. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise të praktikës për të kryer procese pune shëlgjishte për prodhim thupre. - Komplet i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune në shëlgjishte për prodhim thupre. - Udhëzues, katalogje, etj.

4. Moduli “Shfrytëzimi i pyjeve me makina të automatizuara”

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PERSHKRUESII MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHFRYTËZIMI I PYJEVE ME MAKINA TË AUTOMATIZUARA	M-25-2172-25
Qëllimii modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit që të shfrytëzojnë pyjet me metoda te reja dhe moderne dhe makina të automatizuara.	
Kohëzgjatjae modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Pyje”	
Rezultatet e të nxënit(RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përcakton tipet e parcelave të shfrytëzimit. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të zbatojë planin e shfrytëzimit; – të përcaktojë parcelat dhe nën/parcelat për shfrytëzim; – të përcaktojë llojet e transportit të materialit; – të zgjedhë mjetet e punës gjatë shfrytëzimit; – të përcaktojë pjerrësinë e parcelave; – të zgjedhë sheshin e përpunimit të materialit dhe vendosjes së makinës; – të zgjedhë sheshin e depozitimit të materialit të asortuar; – të përcaktojë llojin e makinave në varësi të terrenit; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë depozitimit të materialit; – të theksojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> – <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i>	

RN 2 Nxënësi vëzhgon punën në parcela të sheshta me makina Harvester head John Deere H.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë pozicionin e instalimit të makinës;
- të instalojë makinën në parcelën që do të shfrytëzohet;
- të përgatisë vendin e punës;
- të caktojë vendin e mbetjeve;
- të zgjedhë sheshin e depozitimit të materialeve;
- të përcaktojë proceset e punës që do kryejë makina;
- të caktojë përmasat e asortimenteve;
- të ndajë në asortimente;
- të heqë degët dhe kurorën;
- të heqë lëvoren në drurët halore;
- të transportojë mbetjet në sheshet e mbetjeve;
- të transportojë asortimentet në sheshet e depozitimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi vëzhgon punën e makinës AFM 60 COMBI HARVASTER HEAD ONO & K në parcela me pjerrësi

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë pozicionin e instalimit të makinës;
- të instalojë makinën në parcelën që do të shfrytëzohet;
- të përgatisë vendin e punës për shfrytëzim;
- të zgjedhë sheshin e depozitimit të materialit;
- të përcaktojë proceset e punës që do kryejë makina;
- të përzgjedhë asortimentet që do prodhohen;
- të realizojë ndarjen në asortimente;
- të pastrojë degët dhe kurorën;
- të heqë lëvoren në rastet kur është e domosdoshme;
- të transportojë në sheshet e depozitimit të mbetjeve;
- të transportojë asortimentet në sheshet e depozitimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit dhe të mbrojtjes mjedisit në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrollit

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

Për realizimin e modulit është e domosdoshme të jenë:

- Të instaluar makina në zonat pyjore.
- Instruktori i cili realizon këtë modul duhet të ketë njohuritë e domosdoshme për të dhënë këtë modul.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë

	demonstrime konkrete gjatë punës në parcelë. – Instruktori duhet ti angazhojë sa më shumë nxënësit në këtë proces për të punuar në mënyrë të pavarur, por duke pasur parasysh që këto tipe makinash duan specialistë është e këshillueshme që nxënësit të vëzhgojnë proceset që kryen makina. – Instruktori të mbikëqyrë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në parcelat pyjore. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet vënë theksi tek shprehjet praktike që nxënësi duhet të mësojë dhe përdorimin e mjeteve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	– Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makineritë dhe materialet e mëposhtme: – Ekonomi pyjore për të kryer shfrytëzimet pyjore – Makina të automatizuara për shfrytëzimin e pyjeve. – Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore. – Plane mbarshtimi dhe shfrytëzimi pyjore .

5.Moduli:Shoqëria e nxënësve

Kualifikimi profesional: Silvikulturë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12^{te}

Hartuar në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, “Për zbatimin e moduleve lëndorë Junior Achievement of Albania”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SHOQËRIA E NXËNËSVE	M-17-2199-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të krijuar një shoqëri/ kompani biznesi, për të: kryer procedurat e zgjedhjeve për drejtues e personel, analizuar produktin, kryer proceset e shitjes dhe blerjes, për të promovuar produktin e shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 11 ^{te} , niveli II i KSHK, në profilin mësimor “Ndërtim eficient”.	
Rezultatet e të nxënësve (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi krijon shoqëri/ kompani. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë studimin fillestar të tregut për krijimin e një shoqërie/ kompanie; – të përcaktojë qartë qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë; – të përcaktojë qartë llojin e biznesit (tregti, prodhim, shërbim etj.), si dhe fushën ekonomike në të cilën do të zhvillohet veprimtaria; – të vendosë emrin e shoqërisë/ kompanisë, duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj; – të përcaktojë qartë misionin dhe vizionin në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e shoqërisë/ kompanisë; – të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme, në varësi të mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve; – të hartojë dokumentet themelore juridik (statuti/ rregullore ose akt themelimi); – të regjistrojë shoqërinë/ kompaninë në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB); Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen procedurat e zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë një proces zgjedhor/ rekrutimi transparent (kandidatët, mënyrën e votimit, afatet, rregullat etj.);
- të ndjekë një rend dhe strukturë të caktuar në organizimin e votimeve (në asamblenë e aksionerëve);
- të hartojë një rregullore të qartë dhe të thjeshtë për funksionimin e departamenteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rregullat për zgjedhjen në departamente;
- të prezantojë rolet që duhet të mbulojnë kandidatët e propozuar, sipas departamenteve;
- të respektojë mendimin e shumicës dhe kur ai nuk përputhet me preferencat personale;
- të zgjedhë personin e duhur për drejtues / personel, sipas aftësive për rolin;
- të vlerësojë cilësitë e liderit (motivimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë, përkushtim etj.);
- të përdorë mënyra të ndryshme ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të kontribuojë për një atmosferë bashkëpunuese, gjatë procesit zgjedhor;
- të pranojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi analizon produktin e përzgjedhur objekt i veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qëllimin kryesor dhe dytësorë të studimit të tregut;
- të përcaktojë objektivat e studimit të tregut;
- të përcaktojë metodën bazë për studimin e tregut;
- të krijojë grupin e punës për studimin e tregut dhe të ndajë detyrat në grup;
- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave (intervista, pyetësorë, hulumtim on-line etj.);
- të përgatitë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave të tregut;
- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet në funksion të objektit të studimit të tregut;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të kryejë përpunimin statistikor dhe analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të përgatitë rezultatet e studimit të tregut (gjetjet dhe propozimet);
- të hartojë planin e biznesit duke:
- prezantuar qartë idenë dhe përshkruar në mënyrë të detajuar sipërmarrjen;
- përshkruar qartë prodhimin/ tregtimin;
- përcaktuar karakteristikat që dallojnë ofertën e shoqërisë/ kompanisë së tij nga ajo e konkurrentëve;
- përcaktuar vendndodhjen, ku do të zhvillojë aktivitetin biznesi i saj;
- përcaktuar politikat që ndiqen për produktin apo shërbimin;

- pasqyruar tabelat për shpenzimet e parashikuara dhe të ardhurat e pritshme;
- përcaktuar burimet financiare që nevojiten për të kryer investimet fillestare;
- përshkruar se si do të organizohet biznesi, duke specifikuar numrin e të punësuarve, llojin e kontratave dhe kostot relative;
- të kontrollojë përfundimisht strukturën dhe korrektësinë e përmbajtjes së planit të biznesit;
- të vlerësojë cilësinë, dobishmërinë dhe përputhjen e produktit me nevojat e tregut;
- të vlerësojë përfitimet dhe kufizimet e produktit;
- të vlerësojë mendimet e përdoruesve/ testuesve të produkteve;
- të përmirësojë vazhdimisht produktin, sipas analizimeve të bëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen proceset e blerjes/ shitjes.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit;
- të evidentojë furnitorët potencialë në fushën e biznesit;
- të analizojë furnitorët ekzistues;
- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, gjatë komunikimit me furnitorët;
- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të ndjekë hapat e duhura, gjatë procesit të blerjes;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që përdoret, gjatë procesit të blerjes;
- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të pranojë, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e mbërritura nga klientët;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, gjatë procesit të shitjes;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të përgatitë produktin për shpërndarje;
- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë shoqërisë/ kompanisë, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të zgjidhë situatat në raste ankesash nga klientët;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë blerjes/ shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin të cilit do t'i bëhet marketingu;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediave sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese dhe informuese;
- të hartojë kartëvizitat e materiale të tjera informative për shoqërinë/ kompaninë dhe personelin e saj;
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (software) të ndryshme (Movie maker ose nëpërmjet aparatit celular, smartphone etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me software (photoshop, canva etj.);
- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me promovimin e produkteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të krijojë fushata marketingu, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose mobile marketing);
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë promovimit të produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi harton dhe analizon raportin vjetor.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një pasqyrë të thjeshtë financiare të mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të vetë shoqërisë/ kompanisë;
- të evidentojë saktë se cilët dokumente do të përdoren për regjistrimin dhe pasqyrimin e veprimtarisë;
- të hartojë saktë dokumentet që mund të përdoren në shoqëri/ kompani (ditarin, librin e arkës, libër i magazinës etj.);
- të regjistrojë gjendjen në dokumentet financiare përkatës;
- të regjistrojë saktë derdhjet e aksionerëve në para dhe në natyrë, sipas llojeve;
- të regjistrojë saktë derdhjet e kapitalit të nënshkruar në fillim dhe gjatë veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë;
- të regjistrojë saktë shumat e shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore, si dhe për zgjerimin e veprimtarisë ose ndryshimin e formës juridike;
- të regjistrojë blerjet dhe shitjet e kryera;
- të regjistrojë saktë shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP, duke u bazuar në listëpagesën e pagave;
- të deklarojë në afatin e duhur detyrimet ndaj shtetit;
- të kryejë saktë mbylljen e llogarive të të ardhurave dhe

shpenzimeve;

- të evidentojë rezultatin ekonomik të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rezultatin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë;
- të marrë vendim për shpërndarjen e dividendit, bazuar në përqindjen të aksioneve;
- të kryejë veprimet për likuidimin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë/ klasë dhe në biznes. - Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për: krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë lidhur me krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Udhëzuesi i mësuesit. - Udhëzuesi i nxënësit. - Model statuti dhe akt themelimi. - Modele pasqyrash financiare. - Model letra me vlerë/ aksione. - Libër i arkës. - Libër/ kartela magazine. - Model pyetësori. - Formularë të porositjeve të shitjeve. - Formularë raportimi. - Materiale kancelarie. - Certifikatat e arritjeve. - Kompjuter/ Lap top. - Projektor.

- Internet.
- USB dhe CD.

Programi orientues për provimet përfundimtare për Kualifikimin Profesional “**Silvikulturë**”, **Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe të 13-të.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqëndrohen në ato kompetenca profesionale që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu edhe mësimdhënësit për organizimin e punës, për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Gjatë punës me këtë program kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimin përfundimtar, është e rëndësishme që herë pas here instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve me teste praktik që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Kryerja e inventarizimit dhe zënia e fidanave.	Të realizojë një/disa nga hapat për inventarizimin e fidanëve të mbjellë dhe zënieve të tyre.	25
2	Kryerja e procesit të damkimit të drurit.	Të realizojë një/disa nga proceset e damkimit të drurit.	25
3	Kryerja e llogaritjes së vëllimit të materialit drusor në një sipërfaqe prove.	Të realizojë një llogaritje të thjeshtë të vëllimit të materialit drusor në një sipërfaqe prove(trungjishte).	25
4	Kryerja e shumëzimit vegjetativ të luleve.	Të realizojë një/disa nga proceset e shumëzimit vegjetativ të luleve.	25
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*detyra pune*”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në mjedise të shkollës (kopështi) ose në pyll/fidanishte.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Udhëzime për kryerjen e **Detyrës 1**: “**Të realizojë një/disa nga hapat për**

inventarizimin e fidanëve të mbjellë dhe zënien e tyre”.

Për realizimin e kësaj detyre nxënësi/nxënësit në grupe kryen/kryejnë secili një/disa nga hapat e mëposhtme si:

të orientohet me hartën topografike të pyllit(projektin e pyllëzimit), të bëjë ndarjen në blloqe të përafërt, të kufizojë sipërfaqen provë në terren, të numërojë fidanët e zëna, të numërojë fidanët e thara, të numërojë numrin total të fidanëve në sipërfaqen provë, të llogarisë përqindjen e fidanëve të zëna në sipërfaqen provë dhe të nxjerrë rezultatet për të gjithë sipërfaqen.

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t’ju vihet në vihet në dispozicion nga komisioni i provimit një objekt(ngastër) pyllëzimi ose parcela(ngastër pylli) e shkollës ose ambient pylli i afërt si dhe veglat, pajisjet e materialet e mëposhtme:

hartë topografike, fletore shënimesh, formularët model për inventarizimin e zënieve, lapsa, vizore, uniformat e punës dhe katalogje etj.

Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kriterëve të vlerësimit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe

kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për kryerjen e **Detyrës 2**: “**Të realizojë një/disa nga proceset e damkimit të drurit**”

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësi/nxënësit në grupe kryen/kryejnë secili një/disa prej proseseve të mëposhtme si:

të shënojë drurët me çekiç damkë, të masë me diametër matës diametrin e drurit, të vendosë shënjat e damkimit në fund të drurit, të vendosë shënjat e damkimit në lartësinë 1,5- 2 m, të gdhendë lëvoren deri në blanë, të vendosë numrin rendor të damkimit me bojë, të hartojë listë - damkat etj.

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t’ju vihet në dispozicion një ngastër pylli për damkim si dhe materialet e mëposhtme:

çekiç damke, diametër matës, hipsometër, metërshirit, tabela të gatshme si listë damke me tabelën e kubimit nga merren të dhënat e grumbulluara, harta dhe busull orientuese, makinë llogaritëse, bojë zmalto etj.

Gjatë vlerësimit të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e damkimit të drurit dhe vlerësimit të masës drusore për ndarjen e drurit në lëndë punimi dhe dru zjarri, si dhe asortimentet përcaktëse.

Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kriterëve të vlerësimit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj..

Udhëzime për kryerjen e **Detyrës 3**, “**Të realizojë një llogaritje të thjeshtë të vëllimit të materialit drusor në një sipërfaqe prove(trungjishte)**”.

Për realizimin e kësaj detyre nxënësi/nxënësit në grupe kryen/kryejnë secili një prej proseseve të mëposhtme si:

përcaktimin e metodës së matjes në trungjishte, llogaritjen e numrit të sipërfaqeve provë që do të merren në ekonominë pyjore, përcaktimin e madhësive e sipërfaqeve provë, përcaktimin dhe vendin ku do të merren sipërfaqet provë, inventarizimin e drurëve me diametër 6 cm e lart brenda sipërfaqeve provë, matjen e lartësive të drurëve, matjen e diametrit të drurëve në lartësi 1.30 cm nga toka, përcaktimin e moshës së drurëve, hedhjen e të dhënave e matjeve në fletën e inventarizimit, llogaritjen e dm, Hm dhe Mm të drurëve të sipërfaqes provë si dhe llogaritjen e vëllimit të drurëve për çdo kategori diametrike.

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t’ju vihet në dispozicion nga komisioni i provimit një objekt(ngastër) pyllëzimi si dhe materialet e mëposhtme:

komplete veshjesh të punëtorit, hipsometër, diametër matës, tabela të gatshme si listë damke me tabelën e kubimit nga merren të dhëna e grumbulluara(formular model), harta, busull orientuese, makinë llogaritëse, kanceleri të ndryshme etj.

Gjatë vlerësimit të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e kubimit të drurit dhe llogaritjen e materialit drusor.

Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kriterëve të vlerësimit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për kryerjen e **Detyrës 4**: “**Të realizojë një/disa nga proceset e shumëzimit vegjetativ të luleve**”

Për realizimin e kësaj detyre nxënësi/nxënësit në grupe kryen/kryejnë secili një prej proceseve të mëposhtme si: të ndajë copat për mbjellje, të ndajë copat rrënjore, të ndajë copat gjethore, të pregatisë kalemata për mbjellje, të kryejë mbjelljen.

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t’ju vihet në dispozicion sera e luleve të shkollës si dhe materialet e mëposhtme:

vegla të thjeshta dore, si kazma, bel, shatë, cfurqe, krëhëra, tezga, pleh organik, dherishte, preparate për dezinfektim, farëra të ndryshme të luleve, uniformat e punës, katalogje etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve bëhet verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në fidanishte, serën e luleve.

Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kriterëve të vlerësimit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kriterë për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë gjithashtu dhe një listë kriteresh vlerësimi me tolerancën përkatëse për cilësinë e shërbimit.